REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 234/18
Datë/Datum. 27.02.2018
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PLANI STRATEGJIK I OSHP-së PËR VITET 2018-2020

Prishtinë, Janar 2018

I. PLANI STRATEGJIK I OSHP-së, PËR VITET 2018-2020

1. Themelimi i institucionit

1.1 Struktura e OSHP-së

1.2 Kompetencat e OSHP-së

II. OBJEKTIVAT, VIZIONI, MISIONI I STRATEGJISË

III. NGRITJA E METUTJESHME E KAPACITETEVE

IV. MENAXHIMI I FINANCAVE DHE KONTROLLI I BRENDSHËM

4.1. Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit

4.2. Menaxhimi i të hyrave

4.3. Kontrolli i brendshëm-Auditimi

V. VLERESIMI I RREZIKUT

1. Rreziku për reputacionin;
2. Rreziku strategjik;
3. Rreziku legjislativ;
4. Rreziku financiar;
5. Rreziku menaxherial.

VI. BASHKEPUNIMI NDERINSTITUCIONAL

VII. MARDHENJET ME PUBLIKUN DHE TRANSPARENCA

Hyrje

Ky plan strategjik i vendos qëllimet dhe fushëveprimin për tri (3) vitet e ardhshme. Plani strategjik reflekton synimet, qëllimet dhe prioritetet strategjike të institucionit në tërësi në kontekstin e analizimit të rreziqeve me të cilat institucioni i OSHP-së përballet. Plani strategjik ofron bazat për përgatitjen e planit vjetor.

Strategjia përcakton në përgjithësi një plan për elementet e përmirësimit në fushën e prokurimit publik veçanërisht në shqyrtimin e ankesave.

Plani strategjik parasheh menaxhimin e financave publike dhe të hyrave. Njëkohësisht në planin strategjik parashihet edhe avancimi i ueb-faqes së OSHP-së, duke ju ofruar sa më shumë informata palëve të interesuara.

Vizioni

Vizioni ynë është të jemi në mesin e institucioneve më kredibile, efikase dhe efektive të prokurimit publik, si dhe të jemi institucion meritor në arritjen e objektivave në shqyrtimin e ankesave në mënyrë të drejtë dhe duke pasur për bazë direktivat e BE-së dhe praktikat e mira ndërkombëtare.

I. Themelimi i OSHP-së

OSHP-ja është organ i pavarur shqyrtues dhe ushtron autoritetin, kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara me LPP. OSHP është organ i pavarur për shqyrtim administrativ. OSHP-ja, përbëhet nga pesë (5) anëtar të Bordit. Për mbështetje administrative OSHP-së i ndihmon Sekretariati i cili udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit. Asnjë person ose zyrtar publik nuk mund të ushtrojë ose të përpiqet të ushtrojë ndikim politik ose ndikim të paligjshëm në OSHP apo ndonjë punonjësi të tij për nxjerrjen e ndonjë vendimi.

OSHP është autoritet publik dhe organizatë buxhetore. OSHP është subjekt i të gjitha dispozitave të zbatueshme, ligjeve dhe rregulloreve të Kosovës, në masë të njëjtë sikurse autoritetet e tjera publike dhe organizatat buxhetore.

I.1 Struktura e OSHP-së

Struktura e Organit Shqyrtues të Prokurimit përbëhet nga Kryetari dhe katër (4) anëtarët e Bordit, si dhe stafi mbështetës i cili udhëhiqet nga kryesuesi i sekretariatit të OSHP-së. Në funksion të organizimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka miratuar Rregulloren e Punës së OSHP-së, me nr.01/2017 e datës: 20.03.2017, në të cilën përcaktohen qartë detyrat e Kryetarit të OSHP-së dhe të anëtarëve të Paneleve Shqyrtuese, si dhe procedurat e komunikimit ndërmjet tyre. Gjithashtu janë paraparë edhe detyrat dhe kompetencat e Divizionit për Shqyrtim të ankesave, divizionit të brendshëm, divizionit të financave, sektorit ligjor. Po ashtu është miratuar edhe Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të Organit Shqyrtues të Prokurimit e datës : 02.10.2012 me nr. të Prot .402/12.

I.2 Kompetencat e OSHP-së

1. OSHP mund të përcaktojë se ankesat do të shqyrtohen nga një panel shqyrtues nën OSHP sipas nenit 106 të këtij neni të këtij ligji;

2. OSHP ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi, në kuadër të kushteve të saktësuara në këtë Pjesë IX të LPP-së që;

3. Të shqyrtojnë ankesat nga palët e interesuara lidhur me shkeljet e mundshme të këtij ligji;

4. Të hetojnë dhe të përcaktojnë faktet që kanë shkaktuar ankesat e tilla;

5. T'i japin urdhër çdo personi, ndërmarrje ose autoriteti publik duke kërkuar nga një person, ndërmarrje ose autoritet i tillë që të dorëzojë, bartë, paraqesë dhe/ose mundësojë qasje në të dhëna, informacione, dokumente (përveç këshillave të privilegjuara juridike), dhe/ose artikuj të tjerë të pasurisë së luajtshme dhe/ose të paluajtshme që paneli shqyrtues, në ushtrimin e arsyeshëm të diskrecionit të vet, i konsideron të rëndësishme për zbatimin e hetimeve ose të procedurave për shqyrtimin e prokurimit;

6. Të nxjerrin një urdhër ndaj çdo personi për tu paraqitur në procedurën për shqyrtimin e prokurimit dhe të japë dëshmi lidhur me çdo çështje që paneli shqyrtues, në ushtrimin e arsyeshëm të diskrecionit të tij, i konsideron relevante lidhur me lëndën e kësaj procedure;

7. Të marrin çfarëdo masë tjetër të nevojshme dhe të përshtatshme për të verifikuar argumentet apo pretendimet të bëra nga palët;

8. Nëse kontrata përkatëse nuk është nënshkruar ende ligjërisht nga të dy palët, dhe deri më tani të lejuar nga ky ligj, të japin urdhër me të cilën mënjanohet ose pezullohet dhënia e kontratës publike ose rezultati i një konkursi të projektimit;

9. T'i japin urdhër autoritetit kontraktues, deri më tani të lejuar nga ky ligj, duke e detyruar autoritetin e tillë që të suspendojë ose përfundoj zbatimin e aktivitetit të prokurimit ose zbatimin e vendimit të autoritetit të tillë lidhur me ose gjatë aktivitetit në fjalë;

10. T'i japin urdhër autoritetit kontraktues, deri më tani të lejuar nga ky ligj, duke e detyruar autoritetin e tillë që të anuloj ose revokoj vendimin e autoritetit të tillë lidhur me - ose të marrë gjatë aktivitetit të prokurimit, përfshirë kushtet e paligjshme dhe specifikat në dosjen e tenderit;

11. T'i japin urdhër autoritetit kontraktues duke e detyruar autoritetin e tillë që të ia paguaj kompensimin parashtruesit të ankesës;

12. T'i japin urdhër autoritetit kontraktues duke e detyruar autoritetin e tillë që të korrigjojë shkeljen e pretenduar dhe/ose të parandalojë dëmtimin e mëtejmë të parashtruesit të ankesës dhe/ose të ndonjë pale tjetër të interesuar;

13. T'i japin urdhër autoritetit kontraktues që të mënjanojë specifikimet diskriminuese teknike, ekonomike, financiare ose të përzgjedhjes, kërkesat ose kriteret e përfshira në njoftim, ftesë, dosjen e tenderit ose dokumentet e tjera të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit;

14. Të lëshojnë një urdhër me të cilin detyrohen zyrtarët për zbatimin e ligjit që të ndihmojnë OSHP-në në ekzekutimin e një urdhri të OSHP-së;

15. Të lëshoj një urdhër i cili e shndërron një kontrate te konkluduar dhe të nënshkruar infektive, nëse kontrata është konkluduar pa publikim te njoftimit sipas nenit 42, ose nëse nënshkrimi i kontratës është kryer para skadimit të afatit kohor te përcaktuar në nën-paragrafin 4.1 paragrafi 4. të nenit 26 të këtij ligji;

16. Imponoj gjoba, nëse autoriteti kontraktues, përkundër vendimit te cekur nën-paragrafin 2.13. të këtij neni, vazhdon te vëzhgoj apo të implementoj kontratën e cila është teme e atij vendimi;

17. Kompetenca tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet përkatëse.

II. OBJEKTIVAT

Për të realizuar misionin dhe qëllimin e saj, OSHP-ja, në periudhën afatmesme planifikon qe me buxhetin e paraparë në KASH për vitet 2018-2020, të realizojë këto objektiva:

1. Objektivi kryesor i Organit Shqyrtues të Prokurimit është që të jetë në shërbim të operatoreve ekonomik dhe të mbroje të drejtat e ligjshme nga veprimet apo mos veprimet e Autoriteteve Kontraktuese.
   Rëndësi të veçante për arritjen e kësaj objektive do ti kushtohet profesionalizmit , efikasitetit dhe vendimmarrjes se drejtpërdrejte dhe për përmbushjen e kësaj objektive parasheh qe te ngrit ne vazhdimësi kapacitet institucionale.

2. Objektiv e dyte e OSHP-së, do të jete rritja e transparencës ndaj operatorëve ekonomik dhe për këtë nevojitet avancimi e web-faqes së OSHP-së, për qasje dhe informata sa më të shpejta për palët e interesuara.

3. Vazhdimin e zbatimit të strategjisë së komunikimit, e cila synon zhvillimin e marrëdhënieve me publikun si një proces komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm, me angazhim të plotë të stafit i cili do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të punës së institucionit.

4. Një bashkëpunim më të gjerë me operatorët ekonomik, Autoritetet Kontraktuese, Agjencinë Qendrore të Prokurimit, Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, me mediat, grupet e interesuara dhe publikun e gjerë.

5. Informimin në mënyrë të rregullt dhe transparent për veprimtarinë e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), nëpërmjet krijimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe lehtësisht të monitorueshëm nga komuniteti i biznesit dhe publiku i gjerë për të vlerësuar menaxhimin e ankesave dhe marrjen e vendimeve nga ana e OSHP-së.

6. Funksionalizimi dhe zbatimi i prokurimit elektronik.

7. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare në mënyrë që rregullat e prokurimit publik të jenë në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian si dhe shkëmbimi i përvojave me ekspert vendor dhe ndërkombëtar me qëllim që të përmbushen objektivat e parapara. Bashkëpunimi të fokusohet me shembuj praktik të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, si në trajtim të ankesave po ashtu edhe në vendimmarrje.

III. Ngritja e mëtutjeshme e kapaciteteve profesionale:

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës së OSHP-së, janë të domosdoshëm edhe pesë ekspertë shqyrtues, dy zyrtarë ligjor, një përkthyese shqip serbisht dhe një asistent administrativ.

Në kuadër të përmbushjeve të objektivave, OSHP-së, synon të ketë trajnime të vazhdueshme të nëpunësve civilë në fushat kryesore:

- Menaxhim i përgjithshëm;
- Administratë;
- Burime njerëzore;
- Prokurim publik;
- Partneritet publiko-privat;
- Buxhet dhe financa;
- Teknologji informative.

IV. Menaxhimi i financave dhe kontrolli i brendshëm

Menaxhimi i financave publike ngërthen në vete sfida të veçanta në shpenzimin e parasë publike. Menaxhimi financiar ka për qëllim forcimin e përformancës së organizatës me qëllim të përmbushjes së synimeve dhe objektivave, që nënkupton shpenzim të drejtë të parasë publike dhe menaxhim efikas, efektiv dhe ekonomik.

4 .1 Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit

OSHP, ka hartuar një buxhet vjetor në përputhje me kornizën afatmesme të shpenzimeve (KASH) për periudhën kohore 2018-2020.

OSHP-ja, ka një buxhet të limituar, në krahasim me përgjegjësitë dhe detyrat që i ka të parashikuara me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Ligjin për Partneritet Publiko Privat. Duke pasur parasysh këtë fakt, OSHP-ja po has në vështirësi të madhe në rritjen e stafit profesional dhe avancimin e tij, dhe kjo po ndikon negativisht në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe objektivave të institucionit, si dhe në përmbushjen e detyrave duke pasur parasysh numrin e madh të ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit në periudhën e ardhshme tri (3) vjeçare parasheh ngritjen e kapaciteteve profesionale për përmbushjen e disa objektivave dhe përgjegjësive që dalin nga Ligji i Prokurimit Publik , mirëpo sipas planifikimeve buxhetore rrezikohet që të mos implementohen për shkak se trendët e financimit nuk tregojnë rritje të buxhetit për shkak se buxheti financohet vetëm nga granti qeveritar.

Andaj për përmbushjen e objektivave qe dalin nga plani strategjik nevojitet një rritje e buxhetit prej 20% në kategorinë paga dhe mëditje si dhe mallra dhe shërbime.

4.2 Menaxhimi i të hyrave

OSHP krijon apo grumbullon të hyra në pajtueshmëri me nenin 118 të Ligjit të Prokurimit Publik, si rezultat i tarifave të sigurimit të ankesave dhe gjobave të shqiptuara nga panelet shqyrtuese ndaj autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik.

Këto të hyra grumbullohen në përputhje me rregullat financiarë të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe Departamenti i Thesarit.
Në bazë të një memorandumi të mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit është e nevojshme që një pjesë e të hyrave vetanake të shfrytëzohen për nevoja të institucionit, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Rregullave të Thesarit.

4.3 Kontrolli i brendshëm

OSHP-ja në bazë të Ligjit të menaxhimit të financave publike nuk i plotëson kushtet që të ketë njësi audituese dhe auditor të brendshëm, por auditimi kryhet nga auditoret e Ministrisë së Financave-Njësia Qendrore Harmonizuese dhe Zyra Kombëtare e Auditimit. Funksionimin e kontrollit të brendshëm e parasheh Rregullorja e Punës së OSHP-së nr. 01/2017 e dt:20.03.2017 e cila është në harmoni me Doracakun Për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar të Brendshëm.

V. VLERËSIMI I RREZIKUT

Pjesë e rëndësishme e planit strategjik është që në mënyrë permanente ti identifikojë dhe menaxhojë rrezikun.

Rreziku mund te paraqitet gjatë shqyrtimit të ankesave nga ekspertët shqyrtues, profesional, të jashtëm dhe teknik si dhe gjatë marrjes së vendimeve nga ana e paneleve shqyrtuese. Prandaj, vlerësimi i rrezikut fillon me shqyrtimin e faktorëve të mundshëm që mund të shkaktojnë rrezik, duke u dhënë prioritet më të lartë zbatimit të afateve ligjore, procesit te shqyrtimit nga ekspertet dhe vendimmarrjes se Paneleve Shqyrtuese gjatë shqyrtimit të ankesave.

Tabela: Kategoritë dhe faktorët e rrezikut

Kategoria e rrezikut	Faktori i Rrezikut
Rreziku për reputacionin	
	Dështimi i shqyrtimit të drejtë të ankesave dhe marrja e vendimeve jo meritore;
	Bordi jo funksional
	Vonesa ose dështimi i shqyrtimit të lëndëve dhe marrjes së vendimeve brenda afateve ligjore.
	Mos zbatimi i vendimeve të OSHP-së
	Mos zbatimi i dispozitave të LPP-së me rastin e propozimeve të AK-ve për diskualifikimin e operatorëve ekonomik nga pjesëmarrja në prokurimin publik.
Rreziku strategjik	
	Mënyra e funksionimit nuk është në përputhje me objektivat e institucionit
	Rezultatet nuk përmbushin objektivat e parashikuara
	Menaxhimi jo efikas i trajtimit të ankesave.
Rreziku legjislativ	
	Mos harmonizimi i akteve nënligjore me LPP
	Mos harmonizimi i LPP-së me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike
	Zbrazëtira juridike në inkasimin e mjeteve financiare, të cilat vijnë nga shqiptimi i gjobave.
	Mos harmonizimi i legjislacionit vendor me direktivat e BE-së për shqyrtim të ankesave 2007/66 EC.
	Dhënia e interpretimeve ligjore, jo në harmoni me dispozitat e LPP-së
Rreziku financiar	
	Kufizimet buxhetore
Rreziku menaxherial	
	Mos koordinimi i detyrave dhe përgjegjësive të personelit
	Mos përgjegjësia e menaxhmentit në lidhje me funksionin e kontrollit të brendshëm
	Mos Komunikimi dhe mënyra jo e rregullt e raportimit sipas hierarkisë.

VI. Bashkëpunimi ndërinstitucional

Realizimi i një marrëveshje bashkëpunimi ndër institucionale me Agjencinë Qendrore të Prokurimit dhe me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, me qëllim të evitimit të pengesave aktuale dhe pengesave që do të shfaqen në të ardhmen në sistemin e prokurimit publik.

Bashkëpunimi më i ngushtë me Ministrinë e Financave- Departamentin e Thesarit në lidhje me inkasimin e mjeteve financiare nga shqiptimi i gjobave.

VII. Marrëdhënie me publikun dhe transparenca

Marrëdhëniet me publikun paraqesin përpjekje të vazhdueshme për të vendosur dhe për të mbajtur mirëkuptim të ndërsjellë ndërmjet OSHP-së, Autoriteteve Kontraktuese, operatorëve ekonomik, medieve dhe palëve te interesuara .

Organi Shqyrtues i Prokurimit aktivitetin dhe punën e tij e bënë publike përmes Web faqes së vet, duke publikuar vendimet, Urdhëresat, Konkluzionet, Njoftimet e ndryshme etj.

Përmes Web-faqes së OSHP-së, njoftohen dhe ftohen palët me interes për datën e mbajtjes së seancave dëgjimore.

Seancat dëgjimore janë publike dhe marrin pjesë OJQ të ndryshme, media, përfaqësues të ambasadave të ndryshme etj.

Çdo palë e interesuar mund të marr informacione lidhur me parashtrimin e ankesave përkitazi me aktivitetet e prokurimit. Kjo do të ndikojë në vetëdijesimin e operatorëve ekonomik që në të ardhmen, gjatë përpilimit të ankesave t'i specifikojnë qartë dispozitat ligjore që pretendojnë që janë shkelur nga autoritetet kontraktuese me rastin e zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit. OSHP-ja është e përkushtuar që edhe më tutje të ngritë kapacitetin profesional me synimin që të forcohet edhe më shumë besueshmëria e operatorëve ekonomik në procesin e shqyrtimit të ankesave.

Kryetari i OSHP-së

z.Blerim DINA

REPUBLIKA E KOSOVËS * ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT * PRISHTINË/A TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI REPUBLIKA KOSOVA